




REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot Bi Prot 01-828/15
Nr. llog Broj stranica 02	Data Datum 20.03.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 – 02-107/15, për z. Medain Hashani – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03 – 02-107/15, për zyrtarin e lartë z. Medain Hashani – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Ferizajt, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Hashani është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Kuvendin Komunal të Ferizajt dhe njëkohësisht bashkëpronar në bizneset private “M & K COM”, N.SH. “AUDIT TAX & FAS” dhe N.T.P. “Network Trade”. Po ashtu z. Hashani ka deklaruar se më herët ka ushtruar veprimtari private si konsulent.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëjë në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Hashani është bindur për kufizimin si bashkëpronar në bizneset private dhe po ashtu i është tërhequr vërejtja se nuk mund të ushtroj veprimtari private si konsulent, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 16 (pika 2). Ai ka premtuar që do t'i bëj ndryshimet e nevojshme për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe ka deklaruar se punën e konsulentit e ka ushtruar më herët dhe tani ka kohë që nuk e ushtron këtë veprimtari.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 02/484/15), me të cilat vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

